

# SI DUHET TA KUPTOJMË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE?

*Qerim Qerimi*

## I. HISTORIKU I TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

Fillet e të drejtës ndërkombëtare janë të hershme. Në shkrime më të hershme fetare dhe sekulare, ka dëshmi të shumta rreth asaj që ne sot e njohim si e drejtë ndërkombëtare. Ka shumë traktate të paqes dhe aleancave që janë lidhur ndërmjet hebrenjve dhe romakëve, sirianëve, dhe spartanëve. Romakët kanë njohur të drejtën e kombeve, *jus gentium*, që Gaji (Gaius), në shekullin e dytë, e cilësonte si e drejtë “e të gjithë njerëzve,” një e drejtë universale që mund të aplikohet nga gjykatat romake ndaj të huajve kur e drejta e veçantë e vendit të tyre ishte e panjohur ose e pazbatueshme.<sup>1</sup>

Në shekullin e shtatëmbëdhjetë, juristi holandez Hugo Grocius argumentonte se e drejta e kombeve, po ashtu, përcaktonte rregulla ligjore të cilat i detyronin shtetet e Evropës. Vepra klasike e Grociusit e vitit 1625, *De Jure Belli ac Pacis* (Për të Drejtën e Luftës dhe Paqes), është gjerësisht e pranuar, më tepër se çdo libër tjetër, si themeluese e disiplinës bashkëkohore të së drejtës së kombeve. Kjo e drejtë (e kombeve), më vonë, më 1789, është riemërtuar nga filozofi anglez Jeremy Bentham (Xheremi Bentam) si “e drejta ndërkombëtare.” Kjo e fundit ka sot përdorim më të gjerë.<sup>2</sup>

E pakta që nga fundi i Luftës Tridhjetëvjeçare më 1648, politika botërore kryesisht ka përfshirë marrëdhëniet e shteteve të pavarura dhe sovrane. Siç do të shihet në vijim, këto marrëdhënie janë zgjeruar, duke përfshirë edhe subjekte të tjera.

E drejta ndërkombëtare ngandonjëherë konceptohet si e ndarë në dy pjesë: publike dhe private. E para kryesisht qeverisë marrëdhëniet ligjore ndërmjet shteteve dhe shteteve e organizatave ndërkombëtare dhe personave (si fizikë ashtu dhe juridikë), derisa e dytë, përfshinë ndërveprimet e jashtme të individëve dhe korporatave. Kjo ndarje publike-private mund të mos jetë krejt pa probleme dhe konfuzitet. Shumë prej rregullave dhe proceseve tradicionale brenda sferës së të drejtës ndërkombëtare publike në të vërtetë sot kanë të bëjnë me palët private, dhe jo publike, derisa një pjesë e domenit të së drejtës ndërkombëtare private mbulon ndërveprimet e entiteteve publike. Sidoqoftë, nocionet *publike* dhe *private* mund të konsiderohen sot si shumë popullore, janë gjerësisht të përdorshëm, dhe në këtë mënyrë studiohen edhe si dy lëndë të veçanta në shumë programe universitare.

<sup>1</sup> *Shih* përgjithësisht MARK W. JANIS & JOHN E. NOYES, INTERNATIONAL LAW (CASES AND COMMENTARY) 1 (2001).

<sup>2</sup> *Id.*

## II. PËRKUFIZIMI I TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE SUBJEKTET

Duhet thënë si fillim se definicionet apo përkufizimet, ashtu sikur edhe fjalët që i përbëjnë ato, janë krijesa mendore që formësojnë jo vetëm atë çfarë jemi të vullnetshëm të mendojmë rreth saj, por edhe atë se si ne do të shikojmë në atë për çka ne jemi të gatshëm të mendojmë. Detyra e përkufizimit të vetë “të drejtës,” lëre më të së drejtës ndërkombëtare, nuk është një detyrë e lehtë. Padyshim, ekzistojnë perceptime e konceptime të ndryshme dhe të shumta teorike (shih në pjesën vijuese).<sup>3</sup> Ideja këtu nuk është që të ofrohet ndonjë paraqitje ose kritikë e këtyre përkufizimeve teorike. Është e kundërta, krijimi i një ideje themelore për të drejtën ndërkombëtare, ose edhe më saktë, për subjektet e kësaj të drejte. Për fillim, mjafton të silllet këtu formulimi klasik i Profesorit Louis Henkin të Universitetit të Kolumbisë:

Së pari, e drejta [ligji] është politikë. Studentët e drejtësisë, sikundër dhe studentët e politikës mësohen që të dallojnë të drejtën nga politika... Dallimi në mes të së drejtës dhe politikës është vetëm gjysmë i vërtetë. Në një kuptim më të gjerë, më të thellë, e drejta është politikë. E drejta krijohet nga aktorët politikë, përmes procedurave politike, për rezultate politike. E drejta që krijohet është rezultat i forcave politike; ndikimet e të drejtës në sjelljen e shtetit po ashtu përcaktohen nga forcat politike.

E drejta ndërkombëtare është shprehja normative e sistemit politik. Për të çmuar karakterin e të drejtës ndërkombëtare dhe lidhjen e saj me sistemin politik ndërkombëtar, na ndihmon që të thirremi (ndonëse me kujdes) në të drejtën vendëse si një analog. E drejta vendëse (kombëtare) ... është një shprehje e sistemit politik vendës në shoqërinë vendëse (kombëtare). Një shoqëri vendëse përbëhet nga njerëzit, qeniet njerëzore, megjithëse në shoqëritë e zhvilluara e drejta ka krijuar edhe persona juridikë artificialë (p.sh., kompanitë, asociacionet). E drejta vendëse është një konstrukt i normave, standardeve, parimeve, institucioneve dhe procedurave që u shërbejnë qëllimeve të shoqërisë. ...

Ngjashëm ... e drejta ndërkombëtare është produkt i “shoqërisë” së saj të caktuar, sistemit të saj politik. Edhe e drejta ndërkombëtare është një konstrukt i normave, standardeve, parimeve, institucioneve dhe procedurave ... Por, përbërja e shoqërisë ndërkombëtare është ndryshe. “Personat,” të cilët e përbëjnë shoqërinë ndërkombëtare nuk janë qenie njerëzore individuale, por entitete politike, “shtetet”, dhe shoqëria është një sistem ndër-shtetëror, një sistem i shteteve.<sup>4</sup>

Në fakt, përkufizimi klasik i të drejtës ndërkombëtare është ai i Gjykatës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare, pararendëses së Gjykatës së sotme Ndërkombëtare të Drejtësisë, në

<sup>3</sup> Për një përmbledhje ose paraqitje të metodave kryesore në të drejtën ndërkombëtare, shih STEVEN R. RATNER & ANNE-MARIE SLAUGHTER (EDS.), THE METHODS OF INTERNATIONAL LAW (ASIL, 2004) ose Steven R. Ratner & Anne-Marie Sluaghter, *Appraising the Methods of International Law: A Prospectus for Readers*, 93 AMERICAN JOURNAL OF INTERNATIONAL LAW (1999). Për një trajtim më të hershëm të këtyre metodave, shih RONALD ST. J. MACDONALD & DOUGLAS M. JOHNSTON (EDS.), THE STRUCTURE AND PROCESS OF INTERNATIONAL LAW: ESSAYS IN LEGAL PHILOSOPHY DOCTRINE AND THEORY (1983).

<sup>4</sup> LOUIS HENKIN, INTERNATIONAL LAW: POLITICS AND VALUES (1995), fq. 45.

rastin *Lotus* (Franca kundër Turqisë) të vitit 1927, që në thelb përmban të njëjtit “persona” sikurse formulimi më lartë i Profesorit Henkin. Në këtë vendim, Gjykata thekson: “E drejta ndërkombëtare qeveris marrëdhëniet ndërmjet shteteve të pavarura. Rregullat e kësaj të drejte, të cilat janë detyruese për shtetet burojnë nga vullneti i tyre i lirë, siç është shprehur në konventat apo nga praktikat përgjithësisht të pranuar si parime të së drejtës [zakonet] dhe të krijuara për të rregulluar marrëdhëniet në mes të këtyre komuniteteve të pavarura që bashkëjetojnë apo me vështirim në arritjen e qëllimeve të përbashkëta.”<sup>5</sup>

Sidoqoftë, me kalimin e kohës, zhvillimet e reja të karakterizuara nga nevoja dhe prania më e madhe e individëve dhe e organizatave ndërkombëtare në arenat e jashtme, kanë shtuar elementë të rinj në përkufizimin e të drejtës ndërkombëtare. Kështu, për shembull, *Restatement of Foreign Relations Law*<sup>6</sup> i Shteteve të Bashkuara bën një hap përpara në njohjen edhe të aktorëve jo-shtetërorë në sistemin ligjor ndërkombëtar:

“E Drejta Ndërkombëtare ... përbëhet nga rregullat dhe parimet e aplikimit të përgjithshëm që merren me sjelljen e shteteve dhe të organizatave ndërkombëtare dhe me marrëdhëniet e tyre mes veti, si dhe me disa prej këtyre marrëdhënieve me personat, qoftë fizik apo juridik.”<sup>7</sup>

Në këtë mënyrë, e drejta ndërkombëtare sot funksionon brenda kuadrit të një fushe më të ngarkuar subjektsh, ku përveç shtetit si subjekti ende qendror i të drejtës ndërkombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe personat, fizikë apo juridikë, kanë hyrë si lojtar në sferën e subjekteve të së drejtës ndërkombëtare. Ndonëse në përmasa që ndryshojnë, të gjitha këto subjekte kanë të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga struktura normative ndërkombëtare. Një paraqitje e mundshme skematike, do të mund të ishte kjo në vijim:


---

<sup>5</sup> Permanent Court of International Justice, *The Case of the S.S. “Lotus”*, Ser. A., No. 10, 1927, fq. 18.

<sup>6</sup> Është një përmbledhje ose interpretim i të drejtës, që publikohet nga Instituti Amerikan i të Drejtës, një organizatë e akademikëve ligjorë dhe e atyre që e ushtrojnë profesionin në praktikë.

<sup>7</sup> RESTATEMENT (THIRD) OF FOREIGN RELATIONS LAW § 101.

## Subjektet e të drejtës ndërkombëtare



### III. KONCEPTET TEORIKE

Një “dekonstruktiv” i duhur (nëse huazojmë terminologjinë e Jacques Derrida-s) i kuptimit “E DREJTË NDËRKOMBËTARE PUBLIKE” parakupton pashmangshëm nevojën për të hetuar teorinë ose mendimet teorike për këtë disiplinë.

Le të nisemi me shkollën pozitiviste ose analitike të jurisprudencës, me të cilin studentët (duke qenë më të njohur me kuptimet themelore të së drejtës së brendshme), janë më të familjarizuar. Zakonisht, si pikënisje për diskutim të konceptit të kësaj shkolle merret John Austin, babai themelues me ndikim i pozitivizmit ligjor të shekullit të nëntëmbëdhjetë (shih “The Province of Jurisprudence Determined”), sipas të cilit, e drejta është komandë e sovranit. Ndërsa, e drejta ndërkombëtare për të është pak më tepër se një eufemizëm i moralitetit ndërkombëtar. Për shkollën pozitiviste, pra, e drejta ndërkombëtare nuk është “e drejtë e vërtetë.”

Një qëndrim dyshues ndaj të drejtës ndërkombëtare e ka edhe shkolla e realizmit e marrëdhënive ndërkombëtare. Sipas pikëpamjes realiste të marrëdhënive ndërkombëtare, e drejta ndërkombëtare totalisht nuk ka kurrfarë rëndësie brenda llogarisë utilitare të vendimmarrjes politike ndërkombëtare. E drejta ndërkombëtare, moraliteti, etika, ideologjia, dhe madje edhe dija, sipas kësaj shkolle, janë thjesht komponentë të ekuacionit të pushtetit (forcës), dhe që përdoren si mjete të pushtetit kur vijnë në shprehje interesat vitale të shtetit. Ky qëndrim është artikuluar në shkrimet e realistëve si Edward Hallett Carr, Hans Morgenthau, Dean Acheson, George Kennan dhe Henry Kissinger.

Si rezultat kryesisht i këtij qëndrimi dyshues, dhe edhe i pamundësisë së pikëpamjes pozitiviste për të shpjeguar sistemin ligjor ndërkombëtar—e këtu duhet theksuar se pozitivizmi mbetet peng i të kaluarës, duke u munduar që të korrë prej fjalëve të shkruara në të kaluarën, pavarësisht kontekstit në të cilin janë shkruar dhe pavarësisht që zgjidhja e një problemi sot ose nesër është në rrethana shumë të ndryshme—është shfaqur ajo që njihet si shkolla e realizmit ligjor amerikan, e cila degëzohet në dy drejtime: në shkollën e ashtuquajtur të New Haven-it apo jurisprudencën e orientuar nga politikat, të themeluar nga Myres S. McDougal, Harold D. Lasswell dhe studiues tjerë në Shkollën e Yale-it, dhe Shkolla e Procesit Ligjor Ndërkombëtar, e themeluar në Harvard nga Abram Chayes, Thomas Ehrlich dhe Andreas Lowenfeld. Nëse nisemi nga kjo e fundit (Shkolla e Procesit Ligjor Ndërkombëtar), kontributi i autorëve të kësaj shkolle është më tepër përshkruar (deskriptiv) sesa parashikues (ose preskriptiv), duke dalur me pohimin modest se e drejta është rrallë përcaktuese në çështjet ndërkombëtare, “porse [megjithatë] e drejta është relevante dhe roli i juristëve është i rëndësishëm.”

Ndërsa, sipas Shkollës së New Haven-it, e drejta ndërkombëtare nuk paraqet një trup rregullash, por një proces të vendimeve autoritative dhe të kontrolluara. Në këtë drejtim, Rosalyn Higgins, kryetarja e mëhershme e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë thotë se, e drejta ndërkombëtare nuk është “rregulla,” ndërsa W. Michael Reisman, profesor i të Drejtës Ndërkombëtare në Yale, e quan të drejtën ndërkombëtare edhe si një proces komunikimi, i cili proces përfshinë në vete përmbajtjen e politikave, sinjalin e autoritetit, dhe qëllimin për kontroll. Pra, e drejta në këtë kuptim është një proces i vendimeve autoritative dhe të kontrolluara. Me “kontroll” nënkuptohet instrumenti sanksionues në rast moszbatimi të një vendimi—një nocion ky i huazuar nga e drejta pozitive—ndërsa autoriteti i referohet asaj se kush është i autorizuar, në bazë të çfarë procedurave, të marrë çfarë lloj vendimi, dhe me çfarë efekti. Përfundimisht, ky proces duhet t’i kontribuojë një rendi publik botëror në dinjitet, më saktësisht krijimit të një klime ku të gjithë njerëzit do të kishin mundësinë të kenë qasje në të gjitha vlerat që të gjithë i aspirojnë, dhe këtu McDougal dhe Lasswell, duke huazuar nga antropologjia, historia dhe disiplinat tjera relevante të dijës, i kanë kategorizuar këto vlera në tetë kategori: (1) Pushteti (bërja dhe ndikimi në vendimet komunitare dhe njerëzore); (2) Respekti (e drejta e zgjedhjes, barazia, mirënjohja); (3) Ndriçimi apo iluminizmi (grumbullimi, përpunimi dhe shpërndarja e informacionit dhe e dijës); (4) Mirëqenia (siguria, rehatia, shëndeti); (5) Pasuria (prodhimi, shpërndarja dhe konsumi i të mirave dhe i shërbimeve, kontrolli i burimeve); (6) Shkathtësitë (marrja dhe ushtrimi apo përdorimi i aftësive dhe i mundësive në profesione, arte, karrierë); (7) Dashuria apo miqësia (intimiteti, miqësia, lojaliteti, ndjenjat pozitive); dhe (8) Drejtshmëria apo ndershmëria (pjesëmarrja në formimin dhe aplikimin e normave të përgjegjshme të sjelljes).

Një tjetër teori, është ajo që njihet si teoria kritike ligjore, që për përfaqësues kryesor ka Roberto Unger, David Kennedy dhe Duncun Kennedy në Harvard, dhe Martti Koskenniemi në Helsinki. Kjo teori nuk ka një metodë të caktuar dhe nuk ka asnjë qëndrim të prerë, apo të saktë, por tendenca e tyre e fundit, kryesisht e shprehur përmes shkrimeve të Martti Koskenniemi-t, është kah një kulturë formalizmi.

Përfundimi është që teoritë shpesh ose si rregull janë prodhim i ndodhive reale, dhe ato në të shumtë e herave janë të kufizuara nga ndodhitë që kanë krijuar ato ose të cilat përpiqen t’i shpjegojnë. Në këtë mënyrë, në parim, teoritë janë gati të destinuara të mos jenë në gjendje të

shpjegojnë një fushë të tërë. Asnjë teori e vetme nuk do të mund të shpjegonte në tërësi, me qartësi dhe saktësi të gjithë kompleksitetin e sistemit ndërkombëtar, aq më pak nëse nisim nga premisa sektoriale ose selektive të aspekteve të veçanta të së drejtës ose të një dege të së drejtës. Sidoqoftë, kuptimi i tyre më i mirë është observimi i tyre në kontekst dhe në relacion me teoritë e tjera. Pra, ato kanë kuptim vetëm kur analizohen së bashku.

#### **IV. KRAHASIM: E DREJTA E BRENDSHME DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE**

Një mënyrë tjetër e preferuar për të ofruar një kuptim më të mirë të së drejtës ndërkombëtare mund të përfitohet si rezultat i krahasimit me të drejtën vendëse ose të brendshme.

Si fillim duhet thënë se, e drejta ndërkombëtare, për dallim nga e drejta e brendshme, funksionon brenda një sistemi horizontal, të karakterizuar nga sovranitete konkurruese që, në pjesën më të madhe, nuk janë subjekt i diktateve të një komande të centralizuar dhe strukture fuqizuese, ose të paktën ende jo me bazë të rëndësishme në shkallë botërore.

Profesori Inis L. Claude, Jr. është i njohur për pesë “C”-të e tij, që ndërtohen sipas terminologjisë së përdorur ligjore dhe institucionale në Shtetet e Bashkuara. Këto janë: (1) *Congress* (një legjislaturë qendrore); (2) *Code* (një përmbledhje e shkruar e të gjitha rregullave ligjore); (3) *Courts* (zgjidhja e detyrueshme gjyqësore e mosmarrëveshjeve); (4) *Cops* (policia); dhe (5) *Clinks* (burgjet). Sipas tij, këto pesë “C” i mungojnë të drejtës ndërkombëtare, të cilat përdoren nga disa për të argumentuar se e drejta ndërkombëtare nuk është “e drejtë.”

Megjithatë, në një kontekst krahasimtar, mund të ngrihen paralele, p.sh. me: (1) Asamblenë e Përgjithshme; (2) Kartën e Kombeve të Bashkuara; (3) Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (dhe gjykatat e tribunaleve të tjera ndërkombëtare apo rajonale për fusha të ndryshme); (4) Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara; INTERPOL-in, etj.); dhe (5) instrumentet e ndryshme ndërkombëtare të presionit dhe sanksioneve si: instrumenti diplomatik, presioni ndërkombëtar, izolimi, sanksionet ekonomike, apo instrumenti ushtarak (përdorimi i forcës).

Ndonëse këto paralele mund të vendosen në një kontekst më shumë formal, në përmbajtje, për shembull, Asambleja e Përgjithshme, për dallim prej Kongresit ose Kuvendit të një vendi, nuk miraton ligje që janë detyruese për të gjitha subjektet e të drejtës. Vendimet ose rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme kanë vlerë tipike ligjore të rekomandimit, që përveç rasteve kur mund të fitojnë statusin e zakonit, nuk prodhojnë efekte ligjorisht detyruese. Në varësi të faktorëve që karakterizojnë miratimin e tyre, pastaj përmbajtjen, dhe pranueshmërinë e një rezolute të Asamblesë, ato mund të jenë shpesh tejet autoritative. Tutje, në rastin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, për dallim prej sistemit gjyqësor vendës, jo të gjitha subjektet e të drejtës ndërkombëtare mund të jenë palë përpara saj. Në të vërtetë, për çështje kontestimore, vetëm njëri prej subjekteve të së drejtës ndërkombëtare mund të jetë palë, e ky është shteti. Gjykata Botërore ka dhe një juridiksion tjetër, që është këshillëdhënëse, në cilin rast, autorizime për të bërë kërkesa për mendime këshillëdhënëse kanë Këshilli i Sigurimit, Asambleja e Përgjithshme dhe organet e tjera kryesore të Kombeve të Bashkuara si dhe agjencitë e specializuara brenda fushëveprimtarisë së tyre.

Megjithatë, fakti i dallimeve të mësipërme për sa i përket arkitekturës së ndryshme institucionale dhe procesit, nuk ja mohon të drejtës ndërkombëtare karakterin e një sistemi të veçantë ligjor, sistem që vepron përtej kufijve kombëtar. Mënyra e krijimit apo gjenerimit, ndryshimit apo modifikimit, dhe shfuqizimit të së drejtës ndërkombëtare është, pra, e ndryshme prej mënyrës se si e drejta funksionon në planin e brendshëm. Përkundër këtij fakti të krijimit dhe zbatimit të së drejtës ndërkombëtare nëpërmjet metodave që ndryshojnë rrënjësisht nga qasja tipike e komandës dhe kontrollit të një sistemi kombëtar ligjor, e drejta ndërkombëtare megjithatë ngjason me të drejtën e brendshme derisa ajo përbëhet nga një tërësi rregullash dhe parimesh të cilat ndiqen nga shtetet dhe subjektet e tjera që e përbëjnë të drejtën ndërkombëtare. Njëlloj si e drejta e brendshme, edhe e drejta ndërkombëtare kodifikon ose përmban përkufizime të sjelljeve të pranueshme ose të papranueshme, pritjet rreth veprimeve që mund të ndërmerren në rrethana të caktuara, dhe përcaktime për pasojat e lejuara ose të ndaluara. Kjo tematikë, veçanërisht në kontekstin e procesit të krijimit, më gjerësisht trajtohet në kuadrin e diskutimit për burimet e të drejtës ndërkombëtare.

Përfundimisht, sidoqoftë, e drejta ndërkombëtare, ndonëse funksionon dhe krijohet ndryshe, ajo funksionon mbi bazën e një sistemi subjektësh, të cilat udhëhiqen, sillen ose funksionojnë duke u mbështetur në të drejtat dhe detyrimet të cilat përcaktohen nga procesi i ligjëbërjes ndërkombëtare. Përtej kësaj, në të vërtetë, analiza sektoriale empirike (p.sh., sa i përket zbatimit të vendimeve gjyqësore ose konflikteve civile/të brendshme në krahasim me konfliktet ndërkombëtare), sugjerojnë për një efikasitet më të madh të sistemit ligjor ndërkombëtar.

## V. PSE SHTETET I BINDEN TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

Duke marrë parasysh mënyrën e funksionimit dhe veçanërisht mungesën e një komande të centralizuar ndërkombëtare, pyetja që bëhet shpesh është se pse, megjithatë, pothuajse të gjitha shtetet, siç thotë Louis Henkin, i respektojnë pothuajse të gjitha parimet e të drejtës ndërkombëtare dhe pothuajse të gjitha detyrimet e tyre pothuajse gjatë gjithë kohës. Edhe për këtë qëllim, ekzistojnë konceptione të ndryshme teorike.

Sipas Abram Chayes dhe Antonia Handler Chayes të Shkollës së Harvard-it, shtetet i binden rregullave ndërkombëtare, jo sepse janë të kërcënuara me sanksione, por sepse janë të bindura të veprojnë në pajtim me dinamikën e krijuar nga regjimi i traktateve të cilave u takojnë, përmes një procesi ndërveprues të justifikimit, diskutit dhe bindjes. Ndryshe, ky njihet si modeli menaxherial.

Për dallim prej tyre, Thomas M. Franck nga e ashtuquajtura Shkolla e Manhattan-it, me “Fairness in International Law and Institutions,” thekson se *çelësi* i pajtimit me të drejtën ndërkombëtare nuk është gjithaq procesi menaxherial i Chayeseve, aq sa është legjitimiteti dhe drejtësia e vet rregullave ndërkombëtare.

Një alternativë tjetër teorike është procesi transnacional apo tejkombëtare ligjor i Harold Koh. Procesi transnacional ligjor nënkupton procesin nëpërmes të cilit rregullat e të drejtës

ndërkombëtare interpretohen përmes ndërveprimit të aktorëve transnacional, dhe pastaj brendësohen në sistemin ligjor vendës. Pra, nëse pyetja është: pse shtetet i binden të drejtës ndërkombëtare? Atëherë përgjigjja, sipas Koh, është për shkak të procesit transnacional ligjor të ndërveprimit, interpretimit, dhe brendësimit. Në një kuptim më praktik, ai ofron katër arsye ose faktorë: (1) rastësia ose koincidenca; (2) konformiteti (njerëzit thjesht mund të përshtaten lehtë me diçka që e konsiderojnë të përshtatshme); (3) pajtimi ose pëlqimi (për përfitim personal ose për të shmangur dënimet apo gjobat); dhe (4) bindja (pasi një rregull të jetë përfshirë në sistemin e tij të brendshëm të vlerave).

Si përfundim, pavarësisht dallimeve metodologjike, të gjithë këta arsyetojnë se, nëse qëllimi ynë është një zbatim më i mirë i rregullave globale, atëherë bindja vullnetare, dhe jo pajtimi me forcë, duhet të jetë mekanizmi i preferuar i zbatimit të këtyre rregullave. Me fjalë të tjera, bindja ndaj vendimeve të autoriteteve dhe zbatuesve të ligjit është, në masë të madhe, rezultat i pëlqimit të përgjithshëm, masave shtrënguese dhe i vlerave të përbashkëta dhe të qenësishme për dinjitetin njerëzor, si dhe përfitimeve ekonomike, politike e shoqërore që dalin nga një rend funksional dhe stabil ligjor.